



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 71

Prishtinë, më 1.6.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfë Merxha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Ali Lajçi, Zef Morina, Myrvete Pantina, Berat Luzha, Hestet Cakolli.

Mungoi : Branislav Grbić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 18.5.2010,
3. Rekomandimet lidhur me Raportin nga ZRRUM,
4. Projektligji për mbrojtjen e natyrës,
5. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 18.5.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Raporti nga ZRRUM dhe rekomandimet

Naser Rugova elaboroi shkurtimisht për kërkesat shumë të arsyeshme të përfaqësuesve të rregullatorit, me të cilët ka pasur edhe takime rreth atyre kërkesave. Sugjeroi që komisioni të jap mendimin rreth mbështetjes së tyre. **Naim Maloku** nuk kundërshtoi kërkesat e parashtruara por mori fjalën për të njoftuar se kërkesa e fundit rreth zgjerimit të stafit dhe

pagave shkon përmes Qeverisë, ashtu si është duke u proceduar në kryesinë e Kuvendit lidhur me këto kërkesa (sot p.sh. kryesia ka vendosur lidhur me një kërkesë për zgjerimin me 5 zyrtarë të shkoj kërkesa nga Qeveria në komisionin parlamentar për buxhet).

Komisioni nxori :

R e k o m a n d i m e për seancën plenare

Rekomandimi për përmirësimin e gjendjes në Sektorin e Ujërave

1. Qeveria dhe Komunitat duhet të vejnë në prioritet të aktiviteteve të tyre **në** sektorin e ujit, përf forcimin dhe mbikëqyrjen e afarizmit të ndërmarrjeve publike (kompanive publike) si dhe të investoj në ngritjen e kapaciteteve prodhuese sidomos në KRU “Prishtinë” dhe KRU “Mitrovica”. (KRU – kompania rajonale për ujësjellës).

2. Përmes TFU (task-forca për ujëra) duhet adresuar subvencionimin e rasteve sociale, involvimin e Gjykatave për Zgjedhjen e Problemeve në këta sektorë siç janë : Arkëtimi i Borxheve për shërbimet e ofruara, Mbështetja e kompanive në aspektet Operative si në rastet e kyçjeve ilegale, dëmtime të infrastrukturës, pengesat në leximin e orëmatësve, Pagesa e borxheve të Konsumatorët Institucional (kur dihet se buxhet për shërbimet komunale nuk mund të përdoren për qëllime të tjera), Komunitat, duhet të japin mbështetje përmes mekanizmave të saj sidomos për arkëtimin e borxheve nga Bizneset, Hartimi i planeve komunale për zgjerimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

3. Rregullatori për ujëra dhe mbeturina (ZRRUM), të siguroj se bashku me të gjithë akterët e involvuar në sektorin e ujësjellësve: Ndikim të vazhdueshëm mbi bordet dhe menaxhmentin e Kompanive të ujit për përmirësimin e treguesve të punës, Zvogëlimi i humbjeve të ujit (komerciale dhe teknike), Vendosja e orëmatësve ku ekziston mundësia teknike të banimet kolektive, Ndalimi i faturimit paushall (faturimi të bëhet sipas leximit të orëmatësve), Ndarja proporcionale e ujit (reduktimet e barabarta), Nënshkrimi i kontratave të shërbimit kompani – konsumatorë, Korrigjimi i tarifave të shërbimit (për shkak të mospërmbushjes së investimeve kapitale të planifikuara), Kushtëzimi i donacioneve dhe granteve me performancën e mirë të Kompanive, Vazhdimi i Monitorimit dhe Vlerësimit Krahësues, Kushtëzimi i Licencave për ofrimin e shërbimeve me plotësimin e Standardeve të Shërbimit si dhe Pagesa e Taksës vjetore të Licencimit në kohë për ZRRUM-in nga KUR të licencuara nga ZRRUM.

Rekomandimi për përmirësimin e gjendjes në Sektorin e Mbeturinave

Komunitat – Të angazhojnë inspektoratet për luftimin e deponive të egra në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, të emërohen bordet në Kompanitë e Mbeturinave, të veçohet sipas pakos së Ahtisarit për kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, të nënshkruhen kontratat e shërbimit Kompani- Kuvende Komunale, të ndihmohen kompanitë në inkasimin e faturave të shërbimit përmes mekanizmave administrative komunale sidomos të bizneset dhe institucionet dhe akterët kryesor të definojnë qartë politikën për involvimin e Sektorit Privat.

Kompanitë - të ngritin përgjegjësitë në menaxhim, të zhvillojnë kapacitetet për ngritjen e standardeve të shërbimit (shtimi i aktiviteteve javore për grumbullimin e mbeturinave), të bëhet ngritja e shkallës së faturimit dhe inkasimit, ti bëjnë pagesat e faturave për deponim të mbeturinave ndaj KMDK-së, ti bëjnë pagesat e borxheve ndaj ZRRUM-it për Taksën vjetore të Licencimit dhe të hartojnë planet për zgjerimin e zonës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave.

KMDK (kompania qendrore për menaxhimin e deponive të Kosovës) të ketë mbështetje financiare nga ana e Qeverisë për sajimin e gjendjes së deponive.

Rekomandimi për përmirësimin e strukturës organizative në ZRRUM

Ftohet ZRRUM që lidhur me çështjet organizative të stafit dhe pagave të parashtrori kërkesat në Qeveri përmes ministrisë përkatëse (MEF).

4. Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës

Naser Rugova njoftoi komisionin për mbledhjen e sotme ku duhet fillimisht të caktohen konturat e shqyrtimit të këtij projektligji. Ai përkrahu kundërshtimet e deputetëve nga leximi i parë ku janë shfaqur rezervat për koncesionet me pasuritë natyrore (zonat strikte etj), nene të cilat duhet të hiqen, gjithashtu shprehu brengën se projekti nuk është në përputhje me BE. Lidhur me pretendimet e zyrtarëve të MMPH se duhet të janë 177 nene e jo 208 kjo çështje do të rregullohet në punën e GP i cili caktohet sot. Ai propozoi që lidhur me këtë projekt të organizohen debatet publike në Dukagjin dhe Dragash duke pasur parasysh ndihmën e OJQ-ve (ATRC, REC, Syri Vision etj) të cilët do të bashkëpunojnë me komisionin në vizionin e pasurimit sa më të mirë të projektligjit në fjalë. Në këtë drejtim MMPH do të ofroj ndihmën e nevojshme që konsiston në ofrimin e hartave të zonave, sidomos të atyre strikte. Ai në vazhdim arsyetoi këtë angazhim të komisionit me shumë shembuj siç janë koncesionet për pasuritë që ende nuk i dihet pronari i vërtet (mungesa e ligjit për pronën do të paraqet bllokadën e konsiderueshme në punën e komisionit), lërja e mundësisë për ministrin të rregulloi çështjet profesionale me UA, zbatimi i ligjit si do të bëhet, cilët veprimtari mund të zhvillohen në pasuritë natyrore etj.

Selvie Halimi arsyetoi kërkesën e kryetarit për eliminimin e koncesionit në ligj dhe mbajtjen e dy debateve, por shfaqti brengën si do të mundet komisioni vetëm për dy muaj ti standardizoi gjërat e cekura.

Elheme Hetemi në këtë drejtim falënderoi këshilltarin e komisionit me të cilin bashkëpunon dhe i jap vërejtjet që i ka për këtë projektligj dhe shfaqti dilemën si mund të kontribuohet me akte nënligjore kur me projekt nuk është caktuar çfarë veprimtarish mund të kryhen në këto pasuri nacionale dmth veprimtarit duhen të specifikohen. Edhe ajo shfaqti brengën se dy muaj janë pak për shqyrtim kur dihet se çfarë baze ofron projektligji. Sa i përket standardeve të BE do të kemi problemin e limitimit të mënyrës si të gjejmë zbatimin, tha ajo.

Naser Rugova mbështeti kërkesat e cekura për këtë ligj bazik duke siguruar se komisioni megjithatë do të mbaroi punën para pushimeve verore. Ai u fokusua në bashkëpunimin me qytetarin ngase ligji bëhet për popullatën.

Heset Cakolli u pajtua se bëhet fjalë për një ligj bazik dhe shprehu mendimin lidhur me ditën kur u mbajt seanca për leximin e parë me rastin e vërejtjeve nga deputetët dhe thënies nga ministri se projekti i ka 177 nene (versioni zyrtar i ka 208 nene) e cila zgjoi huti tek ai. Edhe pse ka vërejtje të shumta projektligji, ka bazë për të punuar dhe përmirësuar, mbështeti propozimin për dy debate.

Qazim Kukalaj (këshilltarë) konstatoi se projektligji është përshkrim nga Kroacia me përkthime të deformuara, si ligj kryesorë nuk ofron siguri për zbatimin e ligjeve tjera. Ai tha se duhet të ftohen edhe ca përfaqësues nga fakultete. **Zef Morina** inicioi caktimin e GP, ndërsa komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për mbrojtjen e natyrës do të shqyrtohet nga grupi punues nën kryesimin e Naim Malokut me anëtarët : Selvie Halimi, Heset Cakolli, Qazim Kukalaj dhe përfaqësuesi i MMPH.

2. Deri më 8 qershor të ftohen OJQ të interesuara (REC, Syri Vision, Era, ATRC etj) dhe të ju dërgohet kopja e projektligjit, me të cilët në mbledhjen e komisionit do të

filtrohen kërkesat lidhur me këtë projektligj dhe nevoja për të mbajtur dy debate publike.

3. Pas mbledhjes së komisionit më 8 qershor, grupi punues fillon punën duke sugjeruar hapat e mëtejme brenda afatit për shqyrtimin e projektligjit.

4. Sugjerohet që grupi punues të eliminoi nenet për koncesione dhe gabimet tjera eventuale.

5. Të ndryshme

Naim Maloku njoftoi për miratimin e kërkesës në kryesi për vizitën e komisionit në Bruksel bashkë me administratorin Bajram Badivukun prej 14-18 qershor, ndërkaq edhe bëri me dije që komisioni pas vizitave që do ti kryej duhet të hartoi raportin për kryesi.

Naser Rugova përshëndeti dhe falënderoi përfaqësuesen e UNDP për iniciativën- projektin e vendosjes së kontejnerëve për riciklimin e mbeturinave në 5 komuna , ndaj i ftoj deputetët që me **4 qershor në orën 10,00** (para se të filloj seanca plenare) të prezantojnë në këtë hapje.

Myrvete Pantina përshëndeti projektin, sidomos kur është fjala për Kuvendin e Kosovës ku grumbullohet sasia e madhe e letrave të cilat medoemos duhet të gjejnë përdorimin e mëtejshëm.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,15.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova